

KOMUNIKATË PER SHTYP

Takimi në Tiranë i tre ministrave të drejtësisë nga Ballkani - të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë - në kuadrin e aktiviteteve të Tirana Connectivity Forum i cili mban punimet në datat 7-8 Tetor 2021 në Tiranë, është një indikator i profilit specifik të Shqipërisë në reformat në fushën e sundimit të ligjit. E aprovuar në korrik të vitit 2016, reforma në drejtësi është e njohur kryesisht për procesin e vetingut dhe kohën e gjatë që u nevojiti për të vënë në funksion institucionet e reja të drejtësisë.

Por përvoja shqiptare është shumë më e gjerë. Ajo përfshin së pari mobilizimin e vullnetit politik si kryekusht për fillimin dhe zbatimin e suksesshëm të çdo reforme, dhe jo vetëm në drejtësi. Mbështetja e faktorit politik – në rastin shqiptar, kombëtar dhe ndërkombëtar – ka qënë çelësi i miratimit të reformës në parlament. Po ashtu, konfliktet politike janë ndër arsyt kryesore të vonësive në themelimin dhe funksionimin e institucioneve të reja.

Qeverisja e institucioneve të reja të drejtësisë është risia tjetër ku përvoja shqiptare ofron mësim të dobishme për vendet fqinje. E nisur si një përpjekje për të rinovuar sistemin e drejtësisë, reforma u fokusua drejt vettingut duke mobilizuar burimet njerezore, financiare si dhe vëmendjen e politikë-bërësve, medias dhe qytetarëve. Nevojat e institucioneve të sapo-ngritura në burime njerëzore, mbështetje financiare apo dhe lehtësira logjistike kaluan në plan të dytë.

Si pasojë, ndërsa qytetarët prisnin të kapeshin "peshqit e medhenj", institucionet e reja përpiqeshin të rekrutonin personelin e ri, të gjenin dhe tq mobilonin zyrtarë e reja, të lidheshin me internet dhe infrastrukturën e nevojshme, të draftonin rregulloret e brendshme të institucionit, dhe të siguronin burimet e nevojshme financiare. "Është njësoj sikur të rregullosh veturën në vozitje e sipër" u shpreh një titullar i një institucioni të ri në një tavolinë të rrumbullakët organizuar nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në vjeshtë 2020.

Por ndërkohë institucionet e reja po i afrohen gradualisht funksionimit me regjim të plotë. Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim me mbështetjen e programit MATRA të Ambasadës Hollandeze në Tiranë është fokusuar pikërisht në sfidat që institucionet e sapokrijuara kanë me qeverisjen e kryesisht me buxhetet, burimet njerëzore dhe me procedurat e brendshme. Kjo tryezë është pjesa e tretë e një studimi më të gjerë mbi reformën në drejtësi që përfshin dhe fazën e konceptimit dhe të zbatimit.

Shqipëria, dhe pse nuk ka mbajtur akoma konferencën e parë ndërqeveritare në kuadër të hapjes së negociatave me BE, është në pararojë përsa i përket reformës në drejtësi. Pikërisht për të folur mbi sfidat në të gjithë ciklin e reformës dhe ndarë përvojën me fqinjët, do të shërbejë dhe ky event, i cili organizohet në datë 7 në kuadrin e Tirana Connectivity Forum, pjesë e kalendarit të aktiviteteve të Presidencës Sllovene të Këshillit të BE-së.

Për më shumë informacion kontaktoni arbenite.morina@cdinstitute.eu